



REPUBLICA E KOSOVËS / Republika e Kosovës / Government of Kosovo / Vlada Kosova / Government of Kosovo / Ministria e Shëndetësisë / Министерство Здравства / Ministry of Health / Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës / Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova / National Institute of Public Health of Kosovo

Nr. Prot. 258  
Org. Jedin. 01  
Org. Unit -5-  
Nr. i faqeve  
Br. Stranika  
No. Page

Nr. Prot. 258  
Prot. No.  
Data 14.02.2024  
Datum  
Date

Prishtinë/e

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

## Procedura Standarde e Operimit

# Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe personave tjerë mikrobartës

Versioni: 1.0 Data e Aprovimit:

029024

Autor: II<ShPK

**Prof. Dr. Naser Ramadani**

**Drejtor Ekzekutiv**



APROVUAR

## QËLLIMI

Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe personave tjerë mikrobartës është e detyrueshme për ato kategori punonjësish të cilët mund të kontribuojnë në shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve të caktuara ngjitëse dhe kështu të rrezikojnë shëndetin e një numri të madh personash, të cilët janë përdorues të produkteve apo shërbimeve të tyre.

Kjo PSO ofron udhëzime se si kryhet mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe atyre mikrobartës, me qëllim përfundimtar identifikimin dhe largimin me kohë të këtyre personave nga procesi i ofrimit të shërbimeve të cilat rrezikojnë shëndetin e popullatës nga sëmundjet e caktuara ngjitëse.

## NDËRLIDHJA ME AKTET

1. Masat e veqanta për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse përcaktohen me Procedura standarde operative të nxjerra nga IKSHPK, në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse (Ligji Nr. 08/L-200).
2. Ligji për Inspektoratin Sanitar të Kosovës (Ligji Nr.2003/22).

## FUSHËVEPRIMI

### I. Kush i nënshtrohet mbikëqyrjes sanitare?

1. Personat që punojnë në prodhimin, shitjen, shpërndarjen, përgatitjen dhe shërbimin e artikujve ushqimorë dhe punë të tjera gjatë të cilave cilat bien në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin ose ambalazhimin e ushqimit.
2. Personat e punësuar në furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, si dhe personat që punojnë në prodhimin, ambalazhimin, shitjen dhe shpërndarjen e ujit (pijeve) të ambalazhuar.
3. Personat e punësuar në institucionet parashkollore, cerdhet e fëmijëve dhe institucionet tjera të strehimit kolektiv të kategorive të caktuara të popullatës (shtëpitë e pleqve, qendrat e paraburgimit, burgjet, Qendrat Integruese dhe Rehabilituese, etj.).
4. Personat të cilët në institucionet shëndetësore merren me kontrollin, mjekimin, trajtimin dhe kujdesin ndaj të sëmurëve si dhe mirëmbajtësit e higjienës në shërbimet e përcaktuara më poshtë;
  - Bllloqet operative;
  - Njësitë e kujdesit intensiv;
  - Shërbimet e pediatriisë dhe shërbimet e neonatologjisë;
  - Shërbimet e obstetrikës me njësitë për fëmijët e porsalindur;
  - Shërbimet për trajtimin e djegieve dhe transplantimin e indeve dhe organeve; ● Shërbimet mjekësore estetike;
  - Shërbimet e hemodializës dhe dializës peritoneale; ● Shërbimet e onkologjisë dhe kujdesit paliativ; ● Shërbimet e stomatologjisë dhe kujdesit oral.
5. Personat që punojnë në prodhimin e barnave dhe tregtimin e pajisjeve mjekësore;
6. Personat të cilët punojnë në prodhimin dhe tregtimin e preparateve kozmetike;
7. Personat që ofrojnë kujdes higjienik të popullsisë apo shërbime estetike jo mjekësore sic janë berberët, parukierit, sallonet e masazhit, të pedikyrit dhe manikyrit, shërbimet kozmetike, tatuazhe, piercing (vendosja e vathëve);

8. Personat të cilët gjatë shkollimit kryejnë praktikën e obligueshme në veprimtaritë e lartpërmendura janë të detyruar të kryejnë kontrole sanitare sipas kushteve, afateve dhe mënyrës se përcaktuar për të punësuarit në ato veprimtari.

#### SHËNIM:

- Punonjësit shëndetësorë nuk janë subjekt i detyrimit për të ekzaminuar jashtëqitjen për mikrobe dhe parazit, me përjashtim të atyre që janë të punësuar në shërbimet e pediatriisë, neonatologjisë, mjekimit intensiv, institucionet e strehimit kolektiv të kategorive të caktuara të popullatës, personave të punësuar në ushqyerjen e pacientëve dhe të punësuar në mirëmbajtjen e higjienës në institucionet shëndetësore.
- Personat që ofrojnë kujdes higjenik të popullsisë nuk janë subjekt i detyrimit për të ekzaminuar jashtëqitjen për mikrobe dhe parazit.

### I I. Sa shpesh bëhet mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar

Mbikëqyrja sanitare përfshinë kontrollin shëndetësor sanitar të personave para se të fillojnë ushtrinë dhe në mënyrë periodike gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarive të përshkruara më sipër.

Mbikëqyrja sanitare ndaj kategorive të mësipërme bëhet përmes kontrolleve të rregullta shëndetësore sanitare si më poshtë:

1. Për pikat 1) deri 3) të kësaj PSO kontrollet shëndetësore sanitare kryhen Gdo gjashtë muaj.
2. Për pikat 4) deri te pika 8) e kësaj PSO kontrollet shëndetësore sanitare kryhen një herë në vit.
3. Kontrolli shëndetësor sanitar i këtyre personave bëhet edhe në rast të shfaqjes së sëmundjeve ngjithëse në vendin e punës apo në familjet e tyre, apo kur për këtë gjë ekzistojnë indikacionet epidemiologjike të cilat i konstaton inspektori sanitar.

### III. Masat e obliguese për personat që rezultojnë pozitiv

1. Në prodhimin, qarkullimin dhe në shërbimin e artikujve ushqimorë ose në furnizimin me ujë për konsum njerëzor, nuk lejohet të punojnë personat që janë të sëmurë apo janë bartës të sëmundjeve ngjithëse dhe parazitare.
2. Në institucionet parashkollore, institucione të tjera për fëmijë dhe rini (të tipit të mbyllur) si dhe institucionet të strehimit kolektiv të kategorive të caktuara të popullatës nuk lejohet të punojnë personat që rezultojnë pozitiv në *Staphylococcus aureus* (koagulazë pozitiv), *Streptococcus Bhemoliticus* gr. A, *Salmonellae*, *Shigellae*, si dhe parazitët e zorrëve.
3. Në institucionet dhe në objektet që ofrojnë kujdes higjenik të popullsisë apo shërbime estetike jo mjekësore sic janë rrojtoret, frizerët, sallonet e masazhit, shërbimet kozmetike, të pedikyrit, manikyrit, tatuazhit, piercingut (vendosja e vathëve) nuk lejohet të punojnë personat kanë izolim të mikroorganizmave patogjen apo kanë infeksione të lëkurës.
4. Personat që vuajnë nga tifoja e zorrëve, dizenteria bacilare, salmonellozat, parazitët e zorrëve si dhe personat për të cilët dyshohet se janë mikrobartës të këtyre sëmundjeve, i nënshtrohen kontrollit mjekësor derisa në bazë të ekzaminimit mikrobiologjik të konstatohet se nuk janë më bartës.
5. Personat me ndryshime të dukshme të lëkurës (si pasojë e infeksioneve qelbësuese, kërpudhore apo parazitare) udhëzohen për trajtim dermatologjik.

6. Personat e dyshuar për tuberkuloz pullmonar udhëzohen për trajtim pullmologjik.
7. Referimi për trajtim shtesë nëse dyshohet për infeksion me agjentë të tjerë shkaktarë të sëmundjeve infektive (të cilët nuk janë përmendur më sipër).

#### **IV. Kush e kryen mbikëqyrjen sanitare të personave të punësuar**

Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar kryhet nga Sektori i Shërbimit Sanitar i cili vepron në kuadër të Departamentit të Epidemiologjisë - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, gjegjësisht në Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike (për regjionet përkatës).

#### **V. Cka nevojitet për kryerjen e kontrollit shëndetësor sanitar**

1. Libreza e vjetër sanitare;
2. Dokument identifikimi (kartelë identiteti, patentë shoferi apo pasaportë);
3. 1 fotografi;
4. Dëshmia e pagesës;

**VËREJTJE:** Personat të cilët i nënshtrohen kontrollit sanitar duhet të vijnë në kontroll me duar të pastra dhe thonjtë të shkurtër dhe të pastër. Thonjtë nuk guxojnë të jenë të gjatë, të lyer apo artificial.

#### **VI. Pajisja me librezë sanitare**

Për pajisje me librezë sanitare duhet të plotësohen këto kushte:

1. Ekzaminimi laboratorik (me antibiogram) i strishos së hundës dhe fytit si dhe fecesit;
2. Ekzaminimi i lëkurës dhe mukozave të dukshme për sëmundje të lëkurës;
3. Ekzaminimi i analizave nga ana e mjekut specialist mikrobiolog;
4. Ekzaminimi i rezultateve dhe nënshkrimi i librezës nga mjeku specialist i epidemiologjisë.

Librezat sanitare vërtetohen vetëm kur në rezultate nuk ka izolim të mikroorganizmave patogjen. Librezën sanitare e merr personi që ka kryer kontrollin ose përfaqësuesi i autorizuar institucionit/operatorit ekonomik. IKShPK është i obliguar të mbajë regjistër të veçantë për kontrollet (vizitat) e kryera sanitare. Të gjithë personat të cilët gjatë kontrollit shëndetësor sanitar kanë izolim të mikroorganizmave patogjen duhet ta përsërisin analizën dhe atë:

1. Strishoja e Fytit dhe Hundës përsëritet dy (2) ditë radhazi, duke filluar nga dita e tretë pas përfundimit të terapisë së përshkruar nga mjeku,
2. Koprokultura dhe parazitët përsëritet tre (3) ditë radhazi, duke filluar nga dita e tretë pas përfundimit të terapisë së përshkruar nga mjeku,
3. Ekzaminimi laboratorik i jashtëqitjes së personave me rezultat pozitiv të Salmonellae dhe Shigellae bëhet tre (3) ditë radhazi, duke filluar nga dita e gjashtë pas përfundimit të terapisë së përshkruar nga mjeku.

Personat për të cilët kanë izolim të mikroorganizmave patogjen, i nënshtrohen kontrollit gjithnjë derisa në bazë të rezultatit mikrobiologjik të konstatohet se nuk janë më bartës të infeksionit.

## VII. Udhëzime për institucionet/operatorët ekonomik

Institucionet/operatorët ekonomik obligohen që paraprakisht:

1. Bëjnë kërkesën me shkrim për kontrollë shëndetësore sanitare drejtuar IKShPK (gjegjësisht QRShP), të vulosur dhe nënshkruar nga personi përgjegjës i institucionit (operatorët ekonomik) ;
2. Kërkesës duhet ti bashkëngjitet lista e punëtorëve të cilët do ti nënshtrohen kontrollit (2) ;
3. Kërkesa së bashku me listën e punëtorëve dorëzohet në arkën e IKShPK (apo QRShP në regjione),
4. Nga arka marrin faturën për shërbimin e kërkuar;
5. Kryejnë pagesën përkatëse në bankë, sipas vlerës së Faturës;
6. Kopja e pagesës bashkë me listën e punëtorëve dorëzohet në zyrën e shërbimit sanitar;
7. Në zyrën e shërbimit sanitar merren enët adekuate dhe udhëzimet për mënyrën e marrjes së mostrës së fecesit (mostra sjellët individualisht ditën kur kryhet kontrolli) ;
8. Punëtorët nga lista janë të obliguar të paraqiten për kontrollë shëndetësore sanitare brenda afatit prej dy javëve duke filluar nga data e pagesës së faturës;
9. Punëtorët duhet të paraqiten personalisht dhe të identifikohen përmes dokumentit identifikues;
10. Shërbimi nuk do të ofrohet nëse paraprakisht nuk është sjellë dëshmia për pagesën e kryer;
11. Mostrat merren çdo ditë pune deri në orën 11:00.
  
12. Çmimi i librezës sanitare është 15 euro.

SHËNIM: Rishikimi i kësaj Procedure Standarde të Operimit bëhet një herë në tre vjet me përfshirjen e departamenteve dhe palëve kryesore të interesit.